



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 90/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së panos, më afër se 100 metra nga Qendra e Votimit (QV), në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

#### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, dhe subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se subjekti politik AAK, më datën 29.04.2012, në orën 11:45, në fshatin Pleshinë “ Pesë Dëshmorët e UQK-së “, ka vendosur posterat e kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt, Naim Ferati, Vendvotimin 2506D. Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, Neni 6 paragrafi 1 dhe Rregullës Zgjedhore Nr.09/2009, Neni 7 paragrafi 1 pika (b) dhe pika (f). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.05.2012, në ora 12:00. PZAP, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se posterat e kandidatit për kryetar komune të Ferizajt Naim Ferati nga radhët e subjektit politik AAK janë të vendosura në afërsi më të vogël se 100 metra nga QV 2506D në ditën e votimit të datës 29.04.2012. Sipas Nenit 85 paragrafin 1 të LZP-së, *të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilit do VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohen nga anëtarët e KVV-ve ose menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.*

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik AAK pa dyshim është shkelur dispozita e nenit 85 paragrafin 1 të LZP-së me atë se fotografitë e kandidatit të saj për kryetar komune janë vendosur në afërsi më të afërt se 100 metra nga QV 2506D, si dhe faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit Nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja në Prishtinë**

Anr. 90/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

